

ROVENA VATA

MOTIVI I DASHURISË NË EPOSIN SHQIPTAR (RASTI: MARTESA E HALILIT)

Fjalë kyçe: *Lule, mollë, qershi, Tanusha, krajli i Kotorrit, hanë, zanë*

Ndër llojet e krijimeve më të bukura të poezisë popullore është lirika e dashurisë, e cila në rrafshin artistik korrespondon me gjuhën e simboleve, krahasimeve e të metaforave të ndryshme¹.

Këngët e dashurisë, të çdo periudhe, që nga mesjeta e deri në ditët e sotme, prezantohen si një nga llojet më të pasura të lirikës, duke qenë se shprehin në mënyrë të drejtpërdrejtë shpirtin njerëzor.

Këngët e dashurisë kanë rëndësi të madhe, mbasi në to derdhet thesari i madh i ndjenjave të pastra të shqiptarët, në to jepet ideali i popullit për femrën në mënyrë të veçantë dhe për familjen në mënyrë të përgjithshme², një vend të rëndësishëm në repertorin e rapsodive zënë martesat, rrëmbimet e vajzave të palës kundërshtare, siç ndodh te *Martesa e Halilit*³.

Motivi i dashurisë është një nga elementet kryesore në folklorin shqiptar, dhe si i tillë është element përbërës i krijimtarisë sonë popullore, si: në përralla, proverba, balada, por e gjejmë të mishëruar edhe në epikën tonë legjendare.

Nëse do përkufizonim fjalën *dashuri*, do të shpreheshim se ajo është një ndjenjë, e vjetër sa vetë jeta e qenies njerëzore, një përjetim dhembjeje e kënaqësie, një fushë e veprimit gjithënjëzor⁴.

Ky motiv dashurie në eposin tonë na jepet kështu:

Dheu m'ka mlue e fat s'i qita vedit,

¹ A. Zejnullahu, *Hulumtime në letërsinë popullore*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005, f. 175.

² Gj. Zheji, *Folklori shqiptar*, SHBLSH, Tiranë, 2004, f. 82.

³ *Po aty*, f. 16.

⁴ Rr. Berisha & M. Mustafa, *Këngët e dashurisë I*, Prishtinë, 1979, f. 1.

*po s'e mora Tanushën e krajlit.
E un Tanushën vetë e ko'pa,
kur kem' pasë besë me Krajli.
Gja ma t'mirë s'shef njeri nën ket diell!*⁵.

Profesor Eqrem Çabej i përkufizon këngët e dashurisë, si shpalojnë të institucioneve sociale intime së bashku me shpirtin e fshehtë të njerëzve⁶.

Ndërsa në veprën *Autobiografia e popullit në vargje* të Ismail Kadaresë, gjejmë këtë përkufizim: “Dashuri donte të thoshte konflikt, konflikt me shoqërinë, me familjen, me zakonet, me pronën me gjithçka. Në jetën e tij populli, në shumicën e rasteve nuk e ka pranuar dashurinë, kurse në artin e tij nuk e ka dënuar atë kurrë. Nuk ka asnjë këngë dhe asnjë varg kundër dashurisë”. Dhe më pas shton: “Dashuria në poezinë popullore është përgjithësisht një ndjenjë dramatike e porealizuar, një ëndërr ose ndarje e gjatë”.

*Qi për n'dashtë me m'pru marren te shpija,
he, ktij zoti i shkimët hisen e diellit!
E n'pastë mendën me na koritë fisin,
gjujma, re, qetash me kokërr rreje!
Zirma tokë, përjashta n'natë të vorrit!
At be m'zotin por ka ba:
Kam kam vlla e kah kam motra,
deksha para, n'u martosha!
Se gjithë grat e Krahinës, ku janë,
se gjithë vashat e Jutbinës, ku janë,
bash si motra qi po m'duken*⁷.

Populli shqiptar ndër shekuj është dalluar për virtyte, tipare, simbole, karakteristika etnopsikologjike të veçanta⁸.

⁵ *Martesa e Halilit*, në: “Epika legjendare”, Folklor shqiptar, vëllimi parë, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1966, f. 73.

⁶ E. Çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, Shkodër, 1939, f. 46.

⁷ *Martesa e Halilit*, në: “Epika legjendare”, Folklor shqiptar, vëllimi parë, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1966, f. 72-73.

⁸ *Etnia dhe folklori-funksione përfruese mes popujve*, në: “Kultura popullore”, nr. 1-2/2011, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, f. 61.

*Probatin Vukën vetë e kam pasë,
“falëmeshndet Muji, thuej, t’ka çue;
për një punë, ti vllath, sot me m’ndimue,
me m’ndimue me grosh e me shpatë,
me m’ndimue Tanushën për me e marrë!”⁹.*

Këngët heroike legjendare njihen në popull me termat *kangë* (*kâjkë* a *kâtkë*), *trimash*, *kreshnikësh*, *të Mujit e Halilit*, *agajsh të Jutbinës* etj. Nga këto emërtime del në dritë në mënyrë të qartë karakteri i vetë këngëve. Malësorët këto i këndojnë në dasma, në netët e gjata të dimrit, të verës në bjeshkë, në festat tradicionale, në logje e vende të tjera publike ose në familje¹⁰.

Krijimet artistike rreth martesave, me lashtësinë e tyre dhe me interesin aktual që paraqesin për marrëdhëniet familjare dhe shoqërore të çdo kohe, kanë sjellë, përmes shekujve, elemente etnografike e zakone të periudhave historike të ndryshme. Në rapsoditë tona dallohen elemente që i përkasin martesave të lashta, si elementet e martesave jashtë barkut¹¹.

Studimi i letërsisë gojore është pjesë e pandashme e studimit të letërsisë, sepse nuk mund të ndahet nga studimi i letërsisë së shkruar dhe se midis letërsisë së shkruar dhe asaj të folur ka një bashkëveprim të përhershëm¹².

Po ashtu studimi i letërsisë gojore mbetet një detyrë kryesore për çdo studiues të letërsisë, që dëshiron të kuptojë proceset e zhvillimit të letërsisë, origjinën dhe afrimin e zhanreve e të mjeteve artistike të sotme të letërsisë¹³.

E tërë kjo krijimtari letrare gojore reflekton botën e pasur shpirtërore të etnisë sonë. Nëpërmjet saj shqiptohet jo vetëm pasuria artistike shpirtërore, por edhe doket e zakonet, tiparet dhe virtytet qenësore nëpër shekuj¹⁴. Populli shqiptar ndër shekuj është dalluar për virtyte, tipare,

⁹ Martesa e Halilit, në: “Epika legjendare”, Folklor shqiptar, vëllimi parë, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1966, f. 75.

¹⁰ *Po aty*, f. 7.

¹¹ *Po aty*, f. 16.

¹² R. Welek-A. Warren, *Teoria e letërsisë*, Onufri, Tiranë, 2007, f. 47.

¹³ *Po aty*, f. 47.

¹⁴ M. Mustafa, *Proza gojore, gjendja e studimi dhe perspektiva*, Instituti Albanologjik, Folkloristika shqiptare, dëshmi, problem dhe plane, Prishtinë, 2010, f. 228.

simbole, karakteristika etnopsikologjike të veçanta, nuk përjashtohet se karakteristika të tilla nuk ekzistojnë edhe në popujt e tjerë¹⁵.

Martesa e Halilit është ndër këngët folklorike më të bukura në eposin shqiptar. Kjo këngë në 674 vargjet e saj na rrëfen historinë e dashurisë së Halilit me Tanushën, të bijën e Krajlit të Kotorrit. Fillimi i kësaj këngë me shprehjen *Fort po shndritë njaj diell e pak po xe*¹⁶, na paralajmëron për një situatë sa të bukur dashurie, aq edhe të “pamundur”. Këngës i shtohet bukuria në momentin kur një kreshnik malesh, siç ishte Halili përshkruan bukuritë e Tanushës së Kotorrit.

Vetëm një vlerë artistike me rrënjë të thella në traditë, vetëm një popull që këngën e ka konsideruar si pjesë të realitetit të përditshëm, si kult adhurimi pa të cilin nuk mund të merret me mend jeta njerëzore, ka mundur të ruajë brenda artit të vet emocionalitet të veçantë, që depërton deri në sferat më delikate të ndjeshmërisë njerëzore dhe që mund ta ngazëllezë me bukurinë e shprehjes, me thjeshtësinë e paraqitjes së ideve, edhe njeriun e kohës sonë. Pra, është vlera universale e artit ajo që dëshmon fuqinë e eposit tonë heroik, për t'i mbijetuar shekujve, për ta ruajtur kuptimësinë dhe freskinë që të shijohet edhe sot e kësaj dite, si edhe origjinalitetin e krijimeve artistike të nivelit të lartë, çfarë janë këngët e eposit tonë heroik¹⁷.

Halili, heroi i eposit, i cili nga kushdo njihet për bëmat e tij është aq i zakonshëm dhe i prekshëm, kur bie në dashuri. Ai dashurohet me të huajën, me tjetrën, jo me vajzën vendase. Kur burrat mblidhen rreth tij dhe duan që fisin e tyre ta shtojnë duke u martuar me vajzat e Jutbinës, ai kundërshton me frazën bindëse: “*Se gjithë grat e Krahinës, ku janë, se gjithë vashat e Jutbinës, ku janë, bash si motra qi po m’duken*”¹⁸.

Kreshnikët adhurojnë Tanushën e bukur, një bijë “krajli të Shkejnisë” dhe dashuria fiton mbi armiqtësinë, jeta mposht vdekjen, ndjenja fiton edhe mbi fenë... asnjëherë ndonjë prej heronjve të Ciklit nuk

¹⁵ *Etnia dhe folklori-funksione përafruese mes popujve*, në “Kultura popullore”, nr. 1-2/2011, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 61.

¹⁶ Martesa e Halilit, në: “Epika legjendare”, Folklor shqiptar, vëllimi parë, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1966, f. 71.

¹⁷ S. Feti, *Aspekte të studimeve albanologjike*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2012, f. 265.

¹⁸ Martesa e Halilit, në: “Epika legjendare”, Folklor shqiptar, vëllimi parë, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1966, f. 73.

lëkundet, as ndihet me faj se po lakmon një kaure, qoftë kjo edhe e bija e krajlit¹⁹.

Poeti popullor i kushton kujdes të veçantë përshkrimit të bukurisë së vajzës që dashuron, ndaj përdor krahasimet më të bukura e më të gjetura. Si shembull sjellim përshkrimin e Tanushës së krajlit te Cikli i Kreshnikëve, ku këngëtari për t'i përshkruar pjesët e trupit të vajzës që dashuron, për të ndërtuar krahasimet, ka zgjedhur njëmbëdhjetë objekte të sferave të ndryshme.

Për të krahasuar Tanushën përdoren pjesë anatomike të trupit të saj si: *vetulla, balli, syri, qerpiku, fytyra, hunda, goja, dhëmbët dhe mishi i dorës*.

1- Fytyra - në një këngë te Stravro Frashërit thuhet se ajo ka: “surratin si hënë”²⁰, si p.sh.: *Fytyra e saj si kuqet molla n'degë*²¹.

2- Balli - është ndër pjesët e trupit të vashës që vihet në dukje në këngët tona lirike erotike, si p.sh.: *Shteku i ballit si shteku i malit*²².

3- Vetulla - vetulla e vashës përshkruhet në shumicën e këngëve të dashurisë, në të shumtën e herëve, edhe me anë të figurës së krahasimit. Krahasimi i vetullës është ndërtuar me objekte krahasuese nga më të ndryshmet, që nga rrafshi tokësor e deri tek ai kozmik, gjë e cila dëshmon shijen e hollë estetike të popullit, i cili ka pasur një konsideratë të lartë për të bukurën, sidomos për vetullat, që shquajnë bukurinë, si p.sh.: *Vetulla e saj ndrejt si fiskaja*²³. Vetulla përjetohej artistikisht në këngë me tërë bukurinë e saj, nëpërmjet gajtanit, që shpreh formën, deri diku edhe ngjyrën.

4- Qerpiku - edhe pjesët më të vogla të trupit kanë gjetur vend në këngët tona lirike të dashurisë, si p.sh.: *E ka qerpikun si krahi i dallndyshës*²⁴.

5- Syri - gjatë përshkrimit të pjesëve të trupit janë të rralla rastet kur nuk përmendet edhe syri i vashës, si p.sh.: *Syni i saj si kokrra e qershisë*²⁵.

¹⁹ Sh. Sinani, *Motive paralele në eposin shqiptar dhe në Shahmane*, në: “Perla”, 2005, nr. 3, f. 16-36.

²⁰ S. Frashëri, *Folklor shqiptar, I*, Durrës, 1936, f. 142, nr. 31, v. 4

²¹ *Martesa e Halilit* në: “Epika legjendare”, Folklor shqiptar, vëllimi parë, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1966, f. 73.

²² *Po aty*, f. 73.

²³ *Po aty*, f. 73.

²⁴ *Po aty*, f. 73.

²⁵ *Po aty*, f. 73.

6- Hunda - krahasimi i hundës së vashës në këngët tona lirike të dashurisë bëhet me mjete kryesisht tradicionale, si p.sh.: *Hunda ndrejt si kalemi i Tushës*²⁶.

7- Goja - goja e vashës krahasohet kryesisht me objektin krahasues tradicional - me kutinë, që e ndeshim në shumë figura krahasimi të këngëve të dashurisë. Zakonisht, krahasime të këtilla, si dhe ato për pjesët e trupit të vashës, janë pjesë e pamjes poetike për bukurinë e saj, si p.sh.: *Goja e vogël si lula qi shpërthen*²⁷.

8- Dhëmbët - edhe dhëmbët janë përbërës i pjesëve të vogla të trupit të vashës, por janë dhe objekt shumë i shpeshtë i figuracionit poetik, ndonëse figurat e krahasimit për ta nuk janë edhe aq të shpeshta, si p.sh.: *Dhamet e bardhë si gurzit e lumit*²⁸.

9- Qafa - forma është kryesorja në figurat e krahasimit për qafën e vashës. Me anë të saj shprehet emotivja dhe realja e fiksuar me anë të krahasimit, por me një ngjyrim të kufizuar, si p.sh.: *Qafa e saj si qafa e pllumbit*²⁹.

10- Shtati - që nga ninullat e këndeje, sidomos në këngët e dashurisë dhe ato të dasmës, një vend të rëndësishëm zë shtati i vashës, si p.sh.: *Shtati i saj si 'i shtat çetinet*³⁰.

11- Mishi i dorës - *Mishit e dorës pors rremi i shemshirit*³¹.

Pra siç del nga shembujt e marrë nga Cikli i Kreshnikëve, figura e krahasimit është një ndër figurat më të shpeshta. Krahasimet janë reale, sepse i takojnë rrafshit tokësor të jetës, por edhe pse më së shumti i përgjigjen botës së njeriut: zëri, fuqia trupore dhe forma e trupit, ecja, qëndrimi, ngjyra, emocionet. Në mënyrë të veçantë në rrafshin poetik, ato krijojnë ngjyime të larmishme në pamjet poetike dhe e bëjnë të këndshëm e më të lehtë aktin e përjetimit artistik dhe shprehjen e idealit social-estetik.

Motivi i dashurisë, elementet erotike që paraqiten në vargjet e kësaj kënge e bëjnë atë aktuale në ditët e sotme. Disa nga krahasimet që ai përdor për të përshkruar Tanushën janë: “Shteku i ballit si shteku i malit, syni i saj si kokrra e qershisë, ftyra e saj e kuqe si molla në degë, goja e vogël qi lule që shpërthen”.

²⁶ *Po aty*, f. 73

²⁷ *Po aty*, f. 73.

²⁸ *Po aty*, f. 73.

²⁹ *Po aty*, f. 73.

³⁰ *Po aty*, f. 73.

³¹ *Po aty*, f. 73.

Elemente të tilla si: *qershia, molla, lulja* etj janë mirëfilli shenjat e para të të dëshiruarit të dikujt, shpirtërisht dhe fizikisht. Ajo çfarë e bën këtë këngë të veçantë është mënyra e të shprehurit të dashurisë në formën më të thjeshtë dhe më të bukur.

Që nga Aristoteli e deri më sot nuk është vlerësuar gjithmonë njëlloj roli i tyre, sidomos format e ndërtimit dhe kategorizimi në lloje e nënloje dhe në grupe e nëngrupe, prandaj janë ende çështje e hapur.

Këngët me motivin e dashurisë shprehin me ngrohtësi, emocion dhe elegancë të madhe ndjenja të fuqishme të një dashurie të pastër, të sinqertë dhe krenare, duke zbuluar kështu virtytet e larta të popullit tonë edhe në këtë fushë tepër të rëndësishme të jetës, shprehet Zihni Sako³².

Fatos Arapi shprehet se krahasimi në poezinë popullore, sjell në mënyrë të natyrshme dhe autentike peizazhin e gjerë, ambientin shoqëror, epokën historike, përvojën njerëzore të konkretizuar, është pra, ndër gurët e parë mbi të cilët ngrihet poezia³³.

Figura e krahasimit në këngët tona popullore të dashurisë është një nga shprehjet më të rëndësishme poetike për pasqyrimin e idealit shpirtëror, fizik e estetik, në veçanti për bukurinë fizike dhe shpirtërore të vashës, duke ngërthyer në vete simpatinë, sinqeritetin, afrimin, lutjen, betimin, qëndresën, vetëmohimin, këmbëngulësinë, pafajësinë, virgjërinë, besën, guximin, pritjen, pengesat, dështimin, mallkimin etj. Përmes këtyre shfaqjeve jo vetëm që pasqyrohet aftësia krijuese, por edhe veçoritë etnopsikologjike kombëtare³⁴.

Lirika popullore me motiv kryesor dashurinë është shumë e përhapur në truallin e shqipes. Shtrirja e saj gjeografike nuk njeh kufizime që nga Veriu deri në Jug dhe anasjelltas. Edhe në kontekstin historik gjejmë një zhvillim të këtyre në tërë truallin gjithëkombëtar, që nga lindja e lirikës e deri më sot.

Vasha, pa dyshim, është objekt qendror i këtyre këngëve. Kënga për të, po edhe për djalin, u thur dhe jetoi gjithmonë edhe pas lindjes e pas vdekjes, ajo mbeti kryesore si motiv për fisnikërinë e shpirtit dhe për shprehjen e idealit estetik të popullit tonë brez pas brezi, që njeriu t'i kthehet përsëri jetës për vazhdimësinë e saj dhe të vetvetes.

³² Z. Sako, Parathënie, *Këngë popullore dashurie*, Tiranë, 1965, f. 3.

³³ Z. U. Neziri, *Poetika e krahasimit*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004, f. 25.

³⁴ Z. U. Neziri, *po aty*, f. 28-29.

Bukuria shpirtërore dhe bukuria fizike jetojnë në një unitet të harmonishëm dhe kështu shprehin idealin e tërësishëm estetik e jetësor, “ndonëse e bukura e realitetit dhe e bukura e artit nuk janë identike”³⁵.

Në motivin e dashurisë në eposin shqiptar gjejmë disa nga kategoritë estetike, si: të bukurën, të madhërishmen dhe nuancat e tyre, përjetimi estetik, erotikja, sublimja, përrallorja etj.

*Po s'e mora Tanushën vetë e ko'pa,
Kur kem'pasë besë me Krajli,
Gja ma t'mirë s'shef njeri nën ket diell!*

Në motivin dashuror të eposit shqiptar, shohim se i dashuruari përveç dhimbjes shpirtërore, betohet për dashuri të përjetshme, si në rastin:

*Nji be t'madhe n'emën t'zotit,
njatij t'lumit qi vran e kthiell,
rendon tokë e rendon qiell,
qi, ja martohem me gur e dhe,
ja e kam marrë Tanushën e Krajlit*³⁶.

Një tipar i rëndësishëm i këtij motivi të dashurisë në eposin shqiptar është edhe prania e fantazisë, kjo për t'u dhënë më qartë gjendja e plotë shpirtërore e individit, ndjenjat e tij, dashuri, urrejtje, kënaqësi, dhembje, mërzitje.

BIBLIOGRAFI

- Berisha, Rr. & Mustafa, M., *Këngët e dashurisë 1*, Rilindja, Prishtinë, 1979.
- Çabej, E., *Për gjenezën e literaturës shqipe*, Shkodër, 1939.
- Welek R. & Warren A., *Teoria e letërsisë*, Onufri, Tiranë, 2007.
- Epika legjendare*, “Folklor shqiptar”, vëllimi parë, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1966.

³⁵ A. Uçi, *Estetika, jeta, arti*, Tiranë, 1973, f. 81.

³⁶ *Martesa e Halilit* në: “Epika legjendare”, Folklor shqiptar, vëllimi parë, Instituti i Folklorit, Tiranë, 1966, f. 345.

Motivi i dashurisë në eposin shqiptar (rasti: Martesa e Halilit)

- Fetiu, S., *Aspekte të studimeve albanologjike*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2012.
- Frashëri, S., *Folklor shqiptar, I*, Durrës, nr. 31, Tiranë, 1936.
- Mustafa, M., *Proza gojore, gjendja e studimi dhe prespektiva*, Instituti Albanologjik, “Folkloristika shqiptare, dëshmi, problem dhe plane”, Prishtinë, 2010.
- Neziri, Z., *Poetika e krahasimit*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004.
- Sako, Z., *Parathënie, Këngë popullore dashurie*, Tiranë, 1965.
- Sinani, Sh., *Motive paralele në eposin shqiptar dhe në Shahmane*, në: “Perla”, nr. 3, Tiranë, 2005.
- Uçi, A., *Estetika, jeta, arti*, Tiranë, 1973.
- Zejnullahu, A., *Hulumtime në letërsinë popullore*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005.
- Zheji, Gj., *Folklori shqiptar*, SHBLSH, Tiranë, 2004.

